

fshatare në dinamikën e transformimeve administrative dhe ligjore, të cilat janë bërë në kuadër të shtetit. Kjo problematikë është shtruar në aspektin historik, që është një moment mjaft i volitshëm për të njohur rrugën evolutive të familjeve bujqësore në Sllovaki.

Corrado Barberis, *Sociologjia braka poljoprivrednika u Italiji* (Sociologjia e martesës te bujqit në Itali) f. 213—220. Duke parashtruar temën rreth martesës së qifteve, të cilët merren me bujqësi, autori në fillim evokon mendime të personaliteteve të njohura nga e kaluara historike, që i kanë rekomanduar për femrën apo mashkullin në relacionin fshat-qytet apo shtresë e lartë (e pasur) dhe e ulët (e varfër) në procesin e lidhjes dhe të zgjatjes së martesës, mes dy qifteve. Nga ky moment mësojmë së tradita e vjetër gjatë historisë është përcjellë në disa mese gjer më sot. Duke u bazuar mbi shënime statistikore, autori paraqet rastet e nupcionalitetit dhe të divorcialitetit si dhe bilancet e përgjithshme të tyre. Kështu, pra, gjatë trajtimit të kësaj teme, autori prek edhe në fushën e demografisë sociale.

Mihal Cernea, *Makrosocjalne promjene i trostruka uloga žene u seljačkoj porodici* (Ndryshimet makrosociale dhe roli i trefishtë i gruas në familjen fshatare) f. 221—228. Në këtë punim flitet për pozitën e gruas si dhe rolin e saj në familje, dhe në veprimtarinë bujqësore-në fshat, në vllugun e dinamikës së zhvillimit industrialo-urban në Rumani.

Judit H. Sas, *Masovno zapošljavanje žena i seoska porodica u Madjarskoj* (Inkuadrimi masovik i gruas dhe familja fshatare në Hungari) f. 229—239. Në suaza të këtij punimi, autori studjon mënyrën e jetës dhe ndryshimet, të cilat janë paraqitur në familjet fshatare, me rastin e inkuadrimit të gruas, në veprimtari jashtëbujqësore. Me të dhëna statistikore, ka paraqitur nivelin e standardit jetësor të familjes dhe përdorimin e mjeteve moderne në amëvisni etj.

Gerrit A. Kooy, *Brak, porodica i srodstvo u holandskom selu u sociološkoj*

perspektivi (Martesa, familja dhe farefisnia në fshatin holandez në perspektivën sociologjike) f. 240—246. Kooy, martesën, familjen dhe farefisninë, në Holandë, e paraqet në aspektin e studimit të vet, duke e parashtruar atë në perspektivë të trajtimit të ardhshëm në literaturën sociologjike holandeze dhe botërore.

Nga praktika jonë, është kaptina tjetër, në të cilën janë dhënë disa shënime mbi përvojën dhe organizimin e kurseve të ndryshme në vendin tonë, për ngritjen personale dhe kulture të familjeve, respektivisht të amëviseve në rrethet e ambientit jugosllav. Pastaj, është dhënë një informim mbi ngritjen e femrës fshatare në aspektin e planifikimit të saj për numrin e fëmijëve të lindur, kuptohet në aspektin e shtimit natyral. Është shkruar dhe për mbrojtjen sociale të familjeve të emigrantëve ekonomikë; për maternitetin dhe fëmijët në dritën e masave të reja ligjore.

Bibliografija radova o braku, porodici i srodstvu u seoskim sredinama, 1945—1973 (Bibliografia e punimeve mbi martesën, familjen dhe farefisninë në ambientin fshatar, 1945—1973), e pregatitur nga Zhelko Shporer—Andriçević dhe Mr. Ruzha First-Diliq, paraqet një kontribut të rëndësishëm për njohjen e literaturës sociologjike. Në këtë bibliografi janë botuar 190 tituj. Vlen të përmendet se bibliografia, ndonëse tematike, është klasifikuar në pjesë më të ngushta të këtij lëmi shkencor. Kështu, psh. për familjen e pandarë janë dhënë 21 tituj; për farefisninë 14 tituj; për ekonominë familjare 33; për familjen 54; për familjen dhe rininë fshatare 10 tituj; për martesën 30 tituj dhe për gruan në fshat e bujqësi 28 tituj.

Në bibliografi janë përfshirë vetëm ato punime, të cilat janë botuar në libra dhe revista. Me këtë, fatkeqësisht, kanë ngelë të papërfshira shumë punime të rëndësishme teorike dhe empirike, të prezentuara në tubime shkencore në vend dhe jashtë, e që akoma kanë ngelë të pabotuara.

UKË XHEMAJ

Evlija Čelebi, PUTOPIS, Odlomci o jugoslovenskim zemljama, (Izdavačko preduzeće „Veselin Masleša”, Sarajevo, 1973, f. 1—705).

Udhëpërshkrimet e Evlia Çelepit të shekullit XVII janë të njohura që me kohë në mbarë botën e qytetëruar dhe janë përkthyer në shumë gjuhë, qoftë në fragmente, qoftë në formë fejttoni, ku janë paraqitur

pjesë më të gjata. Botimi i fundit që doli në Sarajevë është një pasqyrë më complete dhe më e saktë nga gjysma e shekullit XVIII mbi viset që sot janë në territorin e Jugosllavisë, sepse këtë përkthim e ka bërë me

shumë kujdes dhe me shumë kompetencë orientalisti i njohur Dr. Hazim Shabanoviq, duke e plotësuar dhe me parathënie e shpjegime e komente përkatëse.

Udhëpërshkrimi (Seyâhatnâmesi) i E. Çelepit përbëhet nga dhjetë vëllime të mëdha, ku autori paraqet shumë e shumë observacione, përshkrime të hollësishme, të dhëna të rëndësishme dhe përshtypjet e veta mbi viset që i ka vizituar në katër anët e Perandorisë Osmane në Azi, Evropë e Afrikë. Ai jep material të çmueshëm për vendbanimet, njerëzit, ngjarjet historike shënime nga jeta ekonomike, politike e shoqërore, përshkrime interesante gjeografike, etnografike, e në disa raste edhe linguistike.

Përkthyesi dhe komentatori i këtij udhëpërshkrimi, H. Shabanoviq, ka zgjedhur për këtë botim vetëm ato pjesë ku bëhet fjalë për viset që i përmendëm më sipër, dhe për ndonjë krahinë ose vendbanim kufitar me vendet fqinje. Këtu ne do të përmendim vetëm ato të dhëna që kanë të bëjnë me viset jugore të Jugosllavisë, ku kanë jetuar dhe ku jetojnë shqiptarët. Evlia Çelepin (1611—1682) ka qenë udhëtar i pasionuar, kështu që edhe viset ballkanike i ka vizituar disa herë, shpesh si shoqëruar dhe person zyrtar i ekspeditave të ndryshme ushtarake dhe të shtabeve të tyre, kështu që ka pasur mundësi të arrijë ku ka dëshiruar. Materialet burimore që i ka mbledhur në terren, më vonë i ka vërtetuar, korrigjuar dhe plotësuar me materiale arkivore dhe me të dhëna nga regjistrimet e ndryshme osmane, ose me materiale që ka marrë nga gjyqet. Prandaj, udhëpërshkrimet e tij kanë vlerë dokumenti, të cilit mund t'i jipet besim i plotë, kuptohet, me ndonjë korrigjim eventual në raste konkrete.

Viset nga Sarajeva e Novipazari deri në Shkup, Manastir e Sofje, Çelepi i ka vizituar në vitin 1660 e 1661, ndërsa disa vise në territorin e sotëm të Shqipërisë, pastaj Gjakovën etj., në vitin 1662. Në disa nga këto vise ka qenë edhe në vitin 1664 dhe 1670. Të dhënat mbi viset jugore të Ballkanit gjenden në vëllimet V, VI e VIII të *Sejâhatnâmesë* (Udhëpërshkrimit). Ja çka thotë E. Çelepi për disa vise e vendbanime, të cilat ne i morëm në shqyrtim me këtë rast.

Novipazari (Jeni Pazar) ka 40—50 mëhallë, 23 xhami, 11 shkolla filllore, 2 teqe, 2 „musafirhane”, 49 kroje, shumë hane, 3000 shtëpi me kopshte të bukura, 1110 duqane e punishte, 2 hamame, 2 saraje të njohura, 2 kuzhina popullore dhe 7

kisha të ortodoksëve dhe të katolikëve. (Këto të dhëna mbi Novipazarin gjenden në faqet 265—268 të librit në fjalë).

Mitrovica (f. 268—269) nuk paraqitet në Udhëpërshkrimin e Çelepiut me ndonjë element të rëndësishëm, ndërsa për *Zveçanin* ai thotë se ka 300 shtëpi, 1 xhami, 1 han, 1 hamam e disa duqane.

Vuçitërna (f. 275—277) atëherë ka pasur 2000 shtëpi, 1 xhami, medresenë, disa teqe e mejtepe dhe hamamin. H. Shabanoviqi këtu bën një vërejtje (në fusnotën nr. 7) dhe thotë se Vuçitërna ka pasur disa xhami të vjetra edhe në atë kohë, nga të cilat edhe sot ekzistojnë 2 sosh — xhamia e Gazi Ali-beut dhe ajo e Karamanogullarit, të ndërtuara më 1444. Çelepi pastaj shkruan se „Popullsia e këtij qyteti është popull i Rumelisë. Ata nuk dinë të flasin boshnjaçe, por flasin shqip e turqisht.” Qyteti ka rrethinat e pasura me vreshta e pemishte, ndërsa popullsia është shumë mikpritëse.

Me këtë rast Çelepi përshkruan edhe tyrben e sulltan Muratit, afër Prishtinës. Ai thotë se paska intervenuar personalisht te pashai për mirëmbajtjen e kësaj tyrbeje, kështu që me këtë rast popullsia muslimane, që banonte në ato fshatra, e rrethoi me mure, dhe u caktua tyrbetari (roja e tyrbes). Banorët e Vuçiternës veshin cohë, qyrk dhe fes të kuq me „turban” (shall), ngjeshin shokën e në shokë mbajnë thikën. Ata mbajnë tirq të ngushtë të kuq me sumbulla ergjëndi dhe pantofla „kabadije”. Këto të dhëna Çelepi i shënoi në vitin 1660.

Prishtina (f. 277—279) ka 2060 shtëpi të zbukuruara me kopshte, bahçe, vreshta e mure oborri. Mes ndërtesave të shumta dallohet konaku i Allajbeut dhe gjykatorja. Qyteti ka 300 duqane e 11 hane tregtare. Një nga këto hane (ai i Haxhi-beut) kishte pllakën me mbishkrim „Ky han është ndërtuar më 1032” (do të thotë më 1622, siç e shpjegon H. Shabanoviq në fusnotën 15). Ndër xhamitë e Prishtinës më tepër vizitohej xhamia e sulltanit (e Fatihut). Kjo xhami ekzistonte edhe sot në gjendje të mirë. Pranë kësaj xhamie, thotë Çelepi, është hamami i sulltan Mehmetit. Ky hamam ekzistonte edhe sot, i shndërruar në banjo publike të qytetit. Qyteti kishte shumë bahçe e vreshta. Popullsia është mikpritëse, kështu që i huaji nuk mbetet asnjë natë pa u ftuar nga ndokush në konak.

Kaçaniku (f. 278—280) ka një kështjellë të bukur e të fortë, thotë Çelepi, të cilën e ka ndërtuar Sinan-pasha, pushtues i Jeme-

nit. Për Sinan-pashën H. Shabanoviçi këtu jep një shpjegim të hollësishëm, duke vënë në dukje se ai ishte shqiptar, i lindur në fshatin Topojan (Lumë). Ka pasur pozita të larta ushtarake e politike (vezir i madh etj.), dhe ka vdekur më 1594, kur ishte 93 vjeç. Shtëpitë e Kaçanikut, thotë E. Çelepi, ndodhen brenda mureve të kalasë (ato të familjeve ushtarake) dhe jashtë këtyre. Mbi derën e një xhamie është shënuar viti 1600, që tregon kohën e ndërtimit të saj. Kaçaniku ka një teqë, një shkollë filllore, një han të madh dhe një hamam.

Novobërda (f. 308) edhe atëherë ishte minierë, nga e cila nxirrej ergjëndi dhe fabrikoheshin monedhat. Autori thotë se në saje të kësaj miniere popullsia është pasuruar shumë. Ai shton se sekretar i kësaj miniere është një poet i njohur, i quajtur Zuhri efendija, me origjinë nga Kaçaniku.

Gjakova (f. 341) gjendet në territorin e Sanxhakut të Dukagjinit. Është vend i bukur dhe ka 2000 shtëpi, 2 xhami të mëdha, disa xhami të vogla dhe hane të mbuluara me plumb. Ka banjon publike në një ndërtesë të bukur dhe 300 duqane plot me mallra të ndryshëm. Çelepi pastaj thotë se Gjakova ka klimë të këndëshme.

Mjerisht, në Udhëpërshkrimin e E. Çelepit (të paktën në këtë vëllim të tij) nuk përmendet Prizreni, për të cilin ky vrojtues syprehtë do të kishte shumë për të thënë. Ai Prizrenin e Pejën thotë vetëm se këto qytete gjenden në Sanxhakun e Dukagjinit.

Kurshumlija (f. 309), thotë E. Çelepi, është një kasabë, vend tregtie, me 250 shtëpi, 3 hane, 10 duqane. Ka një kishë të braktisur dhe 3 xhami.

Kumanova (f. 294) ka 6000 shtëpi. Xhamia në qendër është e bukur. Ka teqë, han, medrese, hamam, një numër të mjaftueshëm duqanesh dhe mullinj. Gjithashtu, thotë autori, Kumanova ka shumë vreshta e kopshte.

Shkupi (f. 280—293) duket se e ka impresionuar mjaft Çelepin. Ai thotë se ky është një qytet i madh me rreth 10.060 shtëpi e me 70 mëhallë, me kështjellë të madhe e me rreth 2.150 duqane. Qyteti ka 45 xhami, ndër të cilat si më e bukur është xhamia e Mbretit të Sahat-kulla, e ndërtuar më 1436 (f. 283). Përveç disa shkollave të tjera fetare, Shkupi ka pasur në at kohë 70 mektebe dhe 20 teqë, disa hamame, e përveç këtyre, edhe 1.060 hamame të vegjël nëpër shtëpi private. Përveç kësaj, qyteti

ka pasur 7 mysafirhane, ku mund të buanin njerëzit pa paguar gjë për fjetje e ushqim. Në Shkup kishte kishë ermene, bullgare, serbe, ebreje. Latinë (katolikë) kishte shumë, por ata i bënë ceremonitë fetare në kishat serbe. Janë në zë disa prodhime tekstili, të punuara me dorë. Kishte atëherë këtu 9 kuzhina popullore, ku kalimtarët e huaj dhe të vendit ushqeheshin pa paguar gjë. Shumica e popullsisë së qytetit, thotë Çelepi, flet turqisht e shqip (f. 288).

Manastiri (f. 305—308) në kohën kur e ka vizituar Çelepi (më 1661) ka pasur rëndësi të madhe ekonomike e administrative, siç e thekson ai vetë qysh në fillim të përshkrimit të tij. Qyteti ka pasur 21 mëhallë me rreth 3.000 shtëpi e me 70 xhami (faltore), 900 duqane e 40 kafene. Mbishkrimi në xhaminë e Mahmud-efendisë mban vitin 1565/6. Këtu ka shumë „eshki” (spahi, pronarë) shqiptarë, thotë Çelepi

Strugën (f. 554—558) Çelepi e trajton më tepër nga aspekti historik dhe thotë se këtë e ka themeluar njëfarë vezir Ustruga. Pastaj, ai përshkruan peshkimin në Liqenin e Ohrit. Struga atëherë kishte 300 shtëpi, me 3 mëhallë muslimane, por edhe me popullsi (greke e bullgare), me 4 faltore (xhami) muslimane, 1 medrese, 1 han, 1 hamam, disa bujtina dhe 40 duqane. Këtu mbahej njëherë në vjet panairi i madh që zgjatte 10 ditë dhe në të mbledheshin 40—50.000 njerëz.

Ohrin (f. 558—570) Çelepi e përshkruan gjerë e gjatë, duke trajtuar çështje historike, ushtarake, ekonomike, fetare etj. Ai jep përshkrim të hollësishëm të kalasë së Ohrit dhe të xhamive, sidomos të asaj që quhet „Aja Sofia”. Hazim Shabanoviçi, në komentin e tij (faqe 550, fusnota nr. 28) shpjegon se Ohrin e kanë pushtuar turqit më 1394 dhe kështu ka mbetur nën pushtetin osman deri më 1446, kur e çliroi Skënderbeu. Ohri, vazhdon Çelepi, ka 17 mëhallë („dhjetë muslimane e shtatë mëhallë të pafeve grekë, bullgarë e latinë”), me 17 faltore muslimane e 6 manastire kristiane, ndër të cilët 1 manastir latin (katolik). Sipas regjistrimit të gjyqit, Ohri ka 400 shtëpi, por shton Çelepi, — thonë se ka 10 deri 15.000 shtëpi, me shumë saraje, ndër të cilët dallohet konaku i Ohruzades. Ohri kishte disa medrese, 7 shkolla filllore, 2 hamame publike, 75 hamame private nëpër shtëpi e saraje, pastaj 150 duqane, 7 kafene, shumë pijetore në mëhallët kristiana, ku pihej verë, 3 bujtina ku s’paguhej për të

fjetur dhe 3 kuzhina për të varfër, ku ushqeheshin falas.

Nuk mund t'i besohet pohimit të Çelepit, kur thotë se e gjithë popullsia flet bullgarisht, greqisht e turqisht, ajo nuk di fare shqip, sepse „Rumelia nuk është e banuar nga shqiptarët.” Këtu ai bie në kundërthënie me vetveten, sepse që nga Vuçiterna, Shkupi etj., ai vë në dukje se popullsia është kryesisht shqiptare, e këto vende e vise ishin gjithashtu në Rumeli dmth. në pjesën evropiane të Perandorisë Osmane). Madje, Çelepi edhe në Novi Pazar përmend katolikët si popullsi të përhershme të këtij qyteti, të cilët mund të thuhet me siguri se kanë qenë shqiptare. Madje edhe në Ohër Çelepi përmend „të pafetë latinë” në ato 7 mëhallë kristiane, dhe 1 manastir latin, që do të thotë — katolik, të cilët patjetër kanë qenë shqiptarë. Shqiptarët e Ohrit mund të kenë folur vetëm turqisht, siç kanë folur edhe në shumë qytete të tjera (në disa edhe sot shumë familje shqiptare flasin turqisht, si psh. në Prizren, Shkup etj.), dhe në bazë të kësaj Çelepi bën një konstatim të tillë të gabuar.

Autori pastaj flet mbi begatitë e mëdha që ka Ohri, sidomos përsa u përket pemëve të ndryshme dhe vreshtave të mira.

Resna (f. 571), në territorin e Sanxhakut të Ohrit, kishte 180 shtëpi, në atë kohë, dy mëhallë me popullsi gjysëm për gjysëm muslimane e kristiane.

Ulqini (f. 339), thotë Çelepi, ka kështjellën e fortë mu në breg të detit. Brenda mureve të saj është xhamia e sulltan Mehmet-hanit. Qytetin e ruajnë, përveç garnizonit, edhe 700 luftetarë shqiptarë. Këtu vijnë djelmohat trima shqiptarë edhe nga kasabe të tjera, hyjnë në fregata (anije) dhe shkatërrojnë bregdetin e armikut. Duke sjellë

mallra pa masë dhe robër të zgjedhur, kthehen në Ulqin si fitimtarë dhe ia japin sanxhakbeut të dhjetën e plaçkës. Kështu i përshkruan Çelepi kusarët e njohur të Ulqinit, aksionet e të cilëve në atë kohë çmoheshin si trimëri e madhe.

Tivari (f. 338) është qytet i fortifikuar. Garnizoni i qytetit, thotë autori, përbëhet nga ushtarët shqiptarë. „Të gjithë këta janë trima shqiptarë, të cilët me fregatat e tyre sulmojnë vazhdimisht vilajetin e Puljës, brigjet e Klorës, qytetet kryenritëse venedikase dhe hajdutët malezias e kelmendas.”

Kotorin (f. 337) Çelepi e ka shikuar vetëm nga një majë, sepse atje nuk mund të shkonte, meqenëse ishte në duar të venedikasve. Për këto vise malore ai thotë se gjysma e tyre quhen Mal i Zi e gjysma Kelmend, ku „jetojnë 47.000 shqiptarë trima, të cilët më parë i takonin Sanxhakut të Shkodrës. Që nga lufta e Kretës ata janë nën sundimin e venedikasve, kështu që kapidani i tyre është venedikas, e ushtarët e tij janë shqiptarë.” Në rrethinat e Perastit (Boka e Kotorrit) fillon „nahija e Kelmendasve që i takon sanxhakut shqiptar të Shkodrës”, ndërsa nga ana e kundër e qytetit Perast, fillon sanxhaku i Hercegovinës (f. 447).

Në këtë pasqyrë të shkurtë të Udhëpërshkrimit të Evlia Çelepit i paraqitëm vetëm ato vende e vise, ku në kohën e udhëtimit të këtij autori ka pasur, ose ka edhe sot, shqiptarë, gjë që ka rëndësi të posaçme për ata që merren me studime albanologjike. Të dhënat që paraqiten këtu janë një material i çmueshëm nga aspekti shkencor për shumë disiplina shoqërore në kuadrin e albanistikës.

MARK KRASNIQI

Demush Shala: KËNGË POPULLORE HISTORIKE, botoi Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSA të Kosovës, Prishtinë 1973, f. 426.

Material i pasur (413 këngë), i zgjedhur, i sistemuar mirë, i prirë nga një parathënie, me shumë të dhëna mbi këngët dhe ku vihen në pah dhe vlerat letrare artistike të tyre — këto janë disa nga elementet që e karakterizojnë blenin — *Këngë popullore historike*, përgatitur nga Demush Shala. Vëllimi, në të cilin janë përfshirë këngë me tematikë historike, është ndarë në 11 kapituj, duke pasur parasysh tematikën e tyre dhe periudhën për të cilën bëjnë fjalë ato. Si model për një ndarje të tillë autori

ka pasur blenin *Këngë popullore historike*, botuar në Tiranë (1956), por duke shtuar ndonjë cikël apo ndonjë element të ri.

Në *Hyrje* të blenit Demush Shala flet mbi disa veçori të përgjithshme të këngëve me tematikë historike, mbi botën tematiko-motivore, mbi rolin që luajtën ato në luftë kundër pushtuesit, mbi vlerat e tyre letrare etj. Ai na bën me dije dhe për disa qëndrime gjatë përpilimit të kësaj përmbledhjeje materialesh të letërsisë gojore shqipe